# DËSHMI ARKIVI

**A-468196**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Protestonte kundër Netanyahu-t para OKB-së, fituesja e çmimit 'Oscar' përfundon në prangat e policisë së Nju Jorkut |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/25/protestonte-kunder-netanyahu-t-para-okb-se-fituesja-e-cmimit-oscar-perfundon-ne-prangat-e-policise-se-nju-jorkut/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 09:17:00 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 09:14:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 09:13:00 UTC → 25 shtator 2026, 09:15:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `73054c2219dec8bf7cb9b1dad2afb0b5733e945c20dd36a841f98c0779a2e2d1` |
| TEKSTI | `d07f800dae3f49036c899d683cf602ce327277bf1d00ce5dc1cd7d7749c2f1d8` |
| PAMJA | `a196a9cf2dd6e469acfdad6ee3f9a6f9172aaeec58ce936e59a98fe313adbc4a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0cba0462686d8e9545e5064c88b378fceb1ad3f3b8630a7b16c541cbb7b8f4ac` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `8b8efb9319bb60e287a9053a50eed732645594d6e8c6608cdfe651dfbc0b1533` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0cba0462686d8e9545e5064c88b378fceb1ad3f3b8630a7b16c541cbb7b8f4ac`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

# Protestonte kundër Netanyahu-t para OKB-së, fituesja e çmimit 'Oscar' përfundon në prangat e policisë së Nju Jorkut

25/09/2026 11:14




**Aktorja e famshme, Susan Sarandon, është arrestuar të enjten në Nju Jork gjatë një proteste pro-palestineze, e zhvilluar jashtë selisë së Kombeve të Bashkuara, në të njëjtën kohë kur kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu mbante fjalimin e tij në Asamblenë e Përgjithshme.**

Aktorja fituese e çmimit "Oscar", ishte mes të paktën 30 personave të arrestuar nga policia e Nju Jorkut gjatë protestës kundër Netanyahu-t. Mes të ndaluarve ishte edhe aktorja Hannah Einbinder, e njohur për rolin e saj në serialin "Hacks", si dhe disa figura politike amerikane.

Mediat e huaja shkruajnë se, protesta u organizua nga "Jewish Voice for Peace", një organizatë aktiviste hebraike që mbështet palestinezët. Rreth 200 persona u mblodhën pranë selisë së OKB-së, ku mbanin pankarta me mesazhe si "Stop armatosjes së Izraelit", "Jo luftës" dhe "Palestinë e lirë".

Policia e Nju Jorkut ka njoftuar se, protestuesit kishin bllokuar një kryqëzim dhe efektivët u kërkuan disa herë të largoheshin. Një pjesë e tyre u zhvendosën në trotuare, ndërsa grupi kryesor vijoi të qëndronte ulur në rrugë. Pas kësaj, policia ndërhyri dhe arrestoi personat që nuk iu bindën urdhrit për t'u larguar.

Pamjet nga protesta tregojnë Sarandon duke u marrë nga efektivët me duart e lidhura, ndërsa edhe Einbinder u shoqërua nga policia. Reuters raportoi se nuk ishte menjëherë e qartë nëse ndaj tyre do të ngriheshin akuza.

Arrestimi i aktores së famshme nuk është i pari rast kur ajo merr pjesë në protesta lidhur me luftën në Gaza. Gjatë Festivalit të Filmit në Venecia këtë muaj, ajo deklaroi se kishte humbur mundësi pune për shkak të qëndrimeve të saj të shprehura publikisht.

Edhe Hannah Einbinder ka folur publikisht për çështjen palestineze dhe ka deklaruar më herët se nuk do të heshtë për këtë temë, edhe nëse kjo mund të ndikojë në karrierën e saj në Hollywood.

Protesta u zhvillua ndërsa Netanyahu përgatitej të fliste në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Gjatë fjalimit të tij, dhjetëra delegacione u larguan nga salla në shenjë proteste.

**Top Channel**


## Bota »








## Kryesore



Akuzohet për përvetësimin e 700 mijë eurove nga Posta Shqiptare, lirohet nga burgu ish-drejtoresha, Elisabeta Mataj
10:48

Plagosja me armë në Lezhë/ Kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin, autorët u larguan me makinë, shpallen në kërkim
09:59

Moti 'përmbys' planet e pushuesve, shiu dhe era boshatisin Lungomaren në Vlorë
10:41

Parashikimi i motit/ Dita e sotme sjell reshje, shtrëngata dhe dëborë në zonat malore
07:05

Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb
10:27

## Më të lexuarat

Top Story/ "Kërkoi ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë", gazetarja Hoxha zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK

"Dumani përzuri Vlorën nga zyra", Murrizi bën deklaratën e fortë në Top Story: E nxori nga qershori i 2025

"Burg, burg", një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico

Bllokohen specat dhe açuget/ Jo vetëm perimet, Shqipëria ka probleme edhe me produktet e detit. Bllokohen në Itali

"Lashë në mes përkthimin e librit të ish-shefit të kundërzbulimit të STAS-it", rrëfimi i Auron Tares: Historia e spiunazhit në Tiranë ia kalon edhe Luftës së Ftohtë

"Po si nuk i fiku njeri radarët për mua moj motër", Kryemadhi batuta dhe ironi për Vlora Hysenin: Meta i ndizte se kishte hallin e vendit, puthte...

"Ke kaluar nga zyra e Ergysit që u bëre deputete?"/ Ministrja Ismaili i përgjigjet fjalës së Berishës në Kuvend: Tek Agasi isha bashkë me Argitën

Top Story/ "Mbrojtja do jetë arrogante", Vangjeli për deklaratën e Vlora Hysenit: Po shantazhon njerëzit me pushtet. Pretendimi i saj për Agasin, i gënjeshtërt



Darka Trump-Xi mbledh elitat në Shtëpinë e Bardhë/ Të ftuarit e Titanëve të Teknologjisë, Arabella 15-vjeçare dhe dollia simbolike

25/09 10:31



YouTube refuzon marrëveshjen e Metës për sigurinë e fëmijëve: Kemi mekanizmat tanë

25/09 10:15



'Do të preferoja të isha në ferr'/ Britania në zi për vdekjen e 12-vjeçares, dyshohet se po përballej me bullizëm

25/09 10:04

Mesazhi i presidentit iranian për Trump, Pezeshkian: Ne jemi gati për marrëveshje, SHBA duhet të vendosë për fundin e luftës

Top Story/ "Hakmarrja është intimidimi i Klodiana Lalës", Murrizi për Vlora Hysenin: Ajo e di kush ka hyrë e kush ka dalë nga zyra e Agasit



Tragjedi në Gaza, shpërthen droni që po përdornin, vriten dy ushtarë izraelitë

25/09 09:50




Përplasje për zgjedhjet në Brazil/ 31 ligjvënës amerikanë akuzojnë administratën Trump për ndërhyrje

25/09 09:47



Trump-Xi me tapet të kuq e banket, por pa marrëveshje për çështjet më të nxehta

25/09 09:41

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News – Kosto e shtetëzimit të rezervave të naftës, Drafti parashikon tarifa për litër karburant




Top News- Përafrimi i politikave me BE/ Mali i Zi vendos viza për rusët, bjellorusët dhe turqit



Top Channel/ Moti 'përmbys' planet e pushuesve, shiu dhe era boshatisin Lungomaren në Vlorë



Top News- Shpërndarës ushqimi dhe kokaine/ Lushnje, arrestohet motoristi i porosive



Top Channel/ Shiste kokainë me motorin e shpërndarjes së ushqimit, arrestohet 31-vjeçari në Lushnjë



Top Channel/ Pas muajsh të tërë thatësire, Fierin e përfshijnë reshjet e dendura të shiut



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.